

## Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

### REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA GJIROKASTER KËSHILLI BASHKIAK

**Komisioni i Përherëshëm i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”**

#### RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. \_\_\_\_\_ datë 30 / 04/ 2026

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit të mëposhtëm përmbledhjen e datës 30.04.2026 ,relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin

**“Për një shtesë në vendimin nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” për shpërndarjen e fondeve të trashëguara’.**

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të VKB-së nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” i ndryshuar.

**Situata aktuale e funksionit** (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

---

Në mbështetje të aktit normativ nr 11, datë 19.12.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, në buxhetin 2025 u akordua fondi 6,722,353.53 lekë, qëllimi kryesor i të cilit ishte pagesa e detyrimeve të prapambetura, dhe diferenca e papërdorur të shkonte për mbulimet e shpenzimeve të tjera. Ky fond është shpërndarë për pagesën e shpenzimeve utilitare të muajve paraardhës dhe mbulimin e shpenzimeve po për këtë kategori për muajt pasardhës.

#### **Situata financiare :** (Shtesa / pakësime në buxhet)

Pas mbylljes së veprimeve financiare me buxhetin 2025, dhe rakordimit me Degën e Thesarit Gjirokastër, buxheti 2025 përveç fondeve të përmendura më lartë sipas aktit normative nr 11 datë 19.12.2025, trashëgon fonde në vlerën 168,963,312.74 lekë nga kapitulli 01, 65,056,516.89 lekë nga kapitulli 05, 5,085,741.27 lekë nga kapitulli 02 dhe 1,987,241.45 lekë nga rimbursimi i shpenzimeve për projektet Herbino dhe Prosfora.

Gjatë planifikimit të buxhetit 2026 janë planifikuar fonde të trashëguara nga kapitulli 01, në vlerën 65,851,103 lekë, dhe nga kapitulli 05, në vlerën 43,454,074 lekë. Për sa më lartë fonde të lira për t’u shpërndarë rezulton nga kapitulli 01, në vlerën 102,662,771.54 lekë, dhe nga kapitulli 05.

Destinacioni fillestar i shpërndarjes së fondeve të trashëguara është mbulimi me fond i projekteve të papërfunduara nga viti 2025 dhe shpërndarja e fondeve të papërdorura për financimin e shpenzimeve të tjera për buxhetin 2026.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar, propozohet shpërndarja e fondeve sipas aneksit nr.1, nr.2, nr 3 dhe saktësimin e zërave buxhetor.

#### **Drejtoria / Sektori përgjegjës**

Drejtoria e Finances

**Monitorimi dhe raportimi :** (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, sipas pershkrimeve ligjore dhe sa here ai e shikon te nevojshme.

---

**Impakti social / grupet që preken:**

Në mbështetje të aktit normativ nr 11, datë 19.12.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, në buxhetin 2025 u akordua fondi 6,722,353.53 lekë, qëllimi kryesor i të cilit ishte pagesa e detyrimeve të prapambetura, dhe diferenca e papërdorur të shkonte për mbulimet e shpenzimeve të tjera. Ky fond është shpërndarë për pagesën e shpenzimeve utilitare të muajve paraardhës dhe mbulimin e shpenzimeve po për këtë kategori për muajt pasardhës.

---

**A është objekt i konsultimit publik:**

jo

Komisioni i Përhershëm i i “**Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik**”

i mbledhur me datën 30 / 04 / 2026, shqyrtoi projekt vendimiN

**“Për një shtesë në vendimin nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” për shpërndarjen e fondeve të trashëguara’.**

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit

d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

\_\_\_\_\_ **Kryetar i Komisionit**  
(emri, mbiemri, firma)

MIHARE LAPA \_\_\_\_\_ **Sekretar i Komisionit**  
(emri, mbiemri, firma)



Datë 30 / 04 / 2026